

UPCOMING EVENTS | IMPORTANT DATES

February 26 | N4CEB Workshop-OEGJK/KDWV

March 5-8 | DACH+HOLZ International

Director's Note

Të nderuar anëtarë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare,

OEGJK këtë javë ka pasur një nga zhvillimet më të rëndësishme, sikur ka qenë themelimi i Fintech Kosovo (FI-KS), së bashku me kompanitë anëtare të teknologjisë financiare në Kosovë. Kjo ka qenë kryefjala e javës, teksa është përcjellë edhe me ngjarje tjera dhe angazhime të rregullta të Odës.

Këtu është një përmbledhje koncize e ngjarjeve kryesore të javës që lamë pas:

Dear members of the German-Kosovar Business Association,

KDWV had one of its most significant developments this week, such as the establishment of Fintech Kosovo (FI-KS), along with member companies of the fintech sector. This has been the headline of the week, accompanied by other events and regular engagements of the KDWV.

Here is a concise summary of the main events of the week we left behind:

Themelohet Fintech Kosova: Pionere në revolucionin e teknologjisë financiare

Me iniciativë të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare (OEGJK) dhe kompanive anëtare Numarics, OneFor, Paysera dhe Swinto është themeluar Fintech Kosova (FIKS), e cila do të funksionojë nën ombrellën OEGJK-së dhe do të udhëheq revolucionin financiar të lidhur me teknologjinë në vendin tonë.

Drejtoresha e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, znj. Nora Hasani ka thënë se me këtë iniciativë dëshirojnë t'i japin zë të fuqishëm kompanive në këtë sektor.

"Ne tanimë i kemi gjashtë klasterë të ndryshëm në kuadër të Odës, për të përfaqësuar 200 kompanitë tona anëtare, për të dhënë një kontribut për të përmirësuar kornizën e të bërit biznes në Kosovë. Duke qenë se i kemi të gjitha kompanitë e Fintech-ut kemi dashtë që këtyre kompanive t'ua japim një zë të veçantë, një zë më të fuqishëm karshi politikbërësve dhe ligjvënësve, edhe kështu që është themelu sot Fintech Kosova", ka thënë Hasani.

Fintech Kosovo Established: Pioneer in the Financial Technology Revolution

With the initiative of the German-Kosovar Business Association (KDWV) and member companies Numarics, OneFor, Paysera, and Swinto, Fintech Kosovo (FIKS) has been established, which will operate under the umbrella of KDWV and will lead the financial revolution related to technology in our country.

The Director of the German-Kosovar Business Association, Ms. Nora Hasani, said that with this initiative, KDWV aims to give a strong voice to companies in this sector.

"We currently have six different clusters within the framework of the Association, to represent the interests of over 200 member companies, in order to contribute to improving the business environment in Kosovo. Since KDWV has all Fintech companies within the membership, we wanted to give these companies a special voice, a stronger voice vis-à-vis policy- and lawmakers. Therefore Fintech Kosovo was established today," said Hasani.

Fintech Kosovo do të punojë në ridefinim të sektorit të shërbimeve financiare në Kosovë dhe Ballkan, duke përdorur inovacionin dhe bashkëpunimin.

Nga kompanitë themeluese, kryesues u zgjodh z. Kristian Kabashi nga Numarics, i cili u shpreh i kënaqur që ka gjetur një ambient të tillë bashkëpunimi.

“Ne po fillojmë këtu një evolucion në vend të revolucionit të një industrie gjigante dhe me shumë potencial në Kosovë”, tha Kabashi.

Pjesë e ceremonisë themeluese ishte edhe zëvendës-Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, z. Dardan Fusha, që tha se është e rëndësishme të gjendet një ekuilibër i rregulluar për të menaxhuar rreziqet e reja që dalin nga inovacionet digjitale.

“Rregullimi i duhur dhe bashkëpunimi, siç është rasti me iniciativat si Fintech Kosovo - FIKS, luajnë një rol kyç në sigurimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të besueshëm për tregun dhe përdoruesit e shërbimeve financiare digjitale”, tha Fusha.

Fjalë rasti ka mbajtur në ngjarje edhe nënkryetari i Komunës së Prishtinës, z. Alban Zogaj, që u shpreh i kënaqur që pikërisht në kryeqytet po ndodhë një ngjarje e tillë.

Fintech Kosovo synon të krijojë një ekosistem të gjallë që nxit inovacionin dhe shtyn rritjen ekonomike.

Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues nga Qeveria, sektori bankar, BERZH, Banka Botërore, si dhe përfaqësues nga ambasada të ndryshme.

Fintech Kosovo will work on redefining the financial services sector in Kosovo and the Balkans, using innovation and collaboration.

Among the founding companies, the elected chairperson Kristian Kabashi from Numarics, expressed his gratitude that he has found such a collaborative environment.

"We are starting here today an evolution instead of the revolution of a giant industry with great potential in Kosovo," said Kabashi.

Part of the founding ceremony was also the Deputy Governor of the Central Bank of Kosovo, Mr. Dardan Fusha, who said it is important to find a balanced regulation to manage the new risks arising from digital innovations.

"Proper regulation and cooperation, as is the case with initiatives like Fintech Kosovo - FIKS, play a key role in ensuring a sustainable and trustworthy environment for the digital financial market and users," said Fusha.

The Deputy Mayor of Pristina, Mr. Alban Zogaj, said in his speech, that he is excited that this started in Prishtina, the capital city.

Fintech Kosovo aims to create a vibrant ecosystem that fosters innovation and drives economic growth.

Representatives from the government, banking sector, EBRD, World Bank and different embassies participated at this event.

Fotografi nga ngjarja e themelimit

Photos from the founding event



KDWW-DEUTSCHLAND

Kosovarisch-Deutsche Wirtschaftsvereinigung
Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare


NEWSLETTER | February 23rd, 2024



Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare




Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare



Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare



Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare



Do të mbahet punëtorja për Ligjin e Burimeve të Ripërtëritshme dhe Problematikat e Kycjes në Rrjet

Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare, në organizim të përbashkët me GIZ dhe me Rrjetin të Bizneseve për Energji të Pastër kanë organizuar për të hënë, më 26 shkurt, punëtori dhe panele diskutimi në të.

Temat të cilat do të diskutohen në këtë punëtori janë Ligji i Burimeve të Ripërtëritshme dhe Problematikat e Kycjes në Rrjet nga gjeneruesit e energjisë së pastër.

Përgjatë punëtorisë do të marrin pjesë profesionistët më të mirë të fushës dhe kompanitë anëtare, teksa me presencë të tij do ta nderojë ngjarjen Zv. Ambasadori Gjerman, z. Matthias Conrad.

Regjistrohuni në info@oegjk.org për pjesëmarrje në këtë ngjarje.

Workshop on the Renewable Energy Resources Law and Issues in Grid Connection to be held

The German-Kosovar Business Association, in joint organization with GIZ and the Business Network for Clean Energy, is organizing a workshop and panel discussion on Monday, February 26th.

The topics to be discussed in this workshop are the Renewable Energy Resources Law and Key Issues in Grid Connection by clean energy generators.

Energy experts and member companies will participate in the workshop, and the event will be honored by the presence of the Deputy German Ambassador, Mr. Matthias Conrad.

Register at info@oegjk.org to participate in this event.

Drejtoresha Hasani mori pjesë në Këshillin Kombëtar për Ekonomi dhe Investime

Drejtoresha e Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare, znj. Nora Hasani ka marrë pjesë në takimin e parë të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime.

Kjo ngjarje e rëndësishme u drejtua nga Kryeministri, z. Albin Kurti.

Director Hasani Attends National Council for Economy and Investment Meeting

The Director of the German-Kosovar Business Association, Ms. Nora Hasani, participated in the first meeting of the National Council for Economy and Investment.

This important event was chaired by Prime Minister, Mr. Albin Kurti.

Përgjatë këtij takimi, drejtoresha Hasani ka mbajtur fjalën e saj, ku ka potencuar rëndësinë e dialogut publiko-privat me Qeverinë e Kosovës.

During this meeting, director, Nora Hasani delivered a speech, emphasizing the importance of the public-private dialogue.

Mes të tjerash, Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare ofroi rekomandime që vijnë direkt nga anëratët e Klasterëve të OEGJK, duke përfshirë temat si top level domain, IP adresa e veçantë për Kosovën, 10 vjetori i procesit të Berlinit, si dhe tërheqja e investitorëve të huaj.

Among other things, the German-Kosovar Business Association introduced the recommendations that come directly from representatives of its Clusters, including topics such as top level domain, national IP address for Kosovo, 10th anniversary of the Berlin process, and attraction of foreign investors.

Vizioni i OEGJK-së që u përçua në këtë takim ishte i qartë: Ta shtyjmë Kosovën drejt një të ardhme me rritje ekonomike dhe zhvillim të qëndrueshëm.

The vision of KDWV conveyed at this meeting was clear: to push Kosovo towards a future of economic growth and sustainable development.



NJOFTIM: ZYRA E OEGJK ËSHTË E MBYLLUR NGA DATA 27.2.2024 DERI MË 1.3.2024